

VENDIM
Nr. 442, datë 18.4.2008

**PËR PËRBALLIMIN E SHPENZIMEVE TË PALËS SHQIPTARE, PJESËMARRËSE
NË OPERACIONIN USHTARAK “ALTHEA” TË BASHKIMIT EUROPIAN,
NË BOSNJË-HERCEGOVINË**

(Ndryshuar me VKM nr. 197, datë 22.2.2012)

(i përditësuar)

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 5 të marrëveshjes, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bashkimit Europian, për pjesëmarrjen e Republikës së Shqipërisë në operacionin ushtarak të Bashkimit Europian për menaxhimin e krizës në Bosnjë-Hercegovinë (operacioni “ALTHEA”), ratifikuar me ligjin nr. 9392, datë 12.5.2005, me propozimin e Ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ministria e Mbrojtjes, brenda fondeve buxhetore vjetore, të përballojë shpenzimet e palës shqiptare, pjesëmarrëse në operacionin ushtarak “ALTHEA” të Bashkimit Europian në Bosnjë-Hercegovinë për:

a) shpenzime kombëtare të drejtpërdrejta, të përdorura për mbështetjen e forcave tona pjesëmarrëse në këtë operacion, si më poshtë vijon:

- shpenzimet për akomodim (fjetje, ngrohje dhe ujë);
- shpenzimet për ushqim;
- shpenzimet për energji elektrike, ujë të pijshëm dhe lavanderi;
- shpenzimet për qira magazinimi;
- shpenzimet për karburant.

b) shpenzime administrative, në funksion të forcave tona pjesëmarrëse në këtë operacion, si më poshtë vijon:

- shpenzimet për siguracion automjeti, mirëmbajtjeje dhe riparime;
- shpenzimet për siguracion shëndetësor;
- shpenzimet për shërbimet telefonike fiks dhe të lëvizshme.

c) *shpenzime për zhvillimin e aktiviteteve social-kulturore në rastet e festave kombëtare, gjatë kohës së kryerjes së misionit.*

2. Efektet financiare që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga fondet e miratuara, për çdo vit, në buxhetin e Ministrisë së Mbrojtjes.

3. Ngarkohet Ministria e Mbrojtjes të nxjerrë udhëzimin përkatës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

KOSTO INDIVIDUALE EOD

NR.	Kosto individuale	Nr. i personave	Vlera ditore	Ditë	Shuma euro	Shuma 000/lekë
I	DIETA	12	70	180	151200	18749
	Ushqim, ujë, larje&akomodim	12	18.6	180	40176	4982
	Shuma				191376	23731
II	Sigurim shëndetësor	12	12	180	25920	3214
	Sigurim jete	12	365	180	7884	788
	Shuma				33804	4002
III	Viza për Bosnje-Hercegovinë	12	50		600	74
	Shuma				0	74
	TOTALI				225180	27808

KOSTO E SHPENZIMEVE TË TJERA

NR.	Kosto e shpenzimeve të tjera	Nr. automjeteve	Sasia e km/muaj	Norma e karburantit për 100/km	Sasia e muajve	Çmimi për litër (euro)	Vlera për 6 muaj (euro)	Vlera për 6 muaj (000/lekë)
1	Shpenzime për karburant	4	460	25 litra	6	0.81	8942	1109
2	Shpenzime për vajtje-ardhje Tiranë-Bosnje e kthim	3	4800	25 litra	2 ditë	0.81	11664	1446
3	Qira magazinimi	2 depo	13 euro/ditë		180 ditë		2400	298
4	Shërbime telefonike (fiks, celular)	1 tel.fiks dhe 2 cel.			180 ditë		10290	1276
5	Mirëmbajtje e mjeteve transportit e pajisje				181 ditë		4000	496
	TOTALI						37296	4625

PASQYRË PËRMBLEDHËSE

NR.	Emërtimi i shpenzimeve	Numri i pjesëmarrësve	Sasia e ditëve	Vlefta në euro	Vlefta në 000/lekë
1	1. Kosto individuale për 6 muaj	12	180	225180	27808
2	2. Kosto e shpenzimeve të tjera	12	180	37296	4625
	SHUMA TOTALE			262476	32432

